



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1568/Prot.,
11

Datë 27 / 7 /2023

VENDIM

Nr. 33 datë 26.072023

“Për miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, neni 3, pika 3, gërma ç), neni 38, pikat 1 dhe 3, neni 98 pika 2 gërma c); VKM nr. 288, datë 21.5.2018, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 7, pika 3, gërma ç), neni 31, gërma u), si dhe në propozimin e Administratorit të UT-së, të mbështetur në propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Tarifat e regjistrimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2023-2024, të jenë si më poshtë:
 - Tarifa e regjistrimit në shumën 1600 lekë.
 - Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit në shumën 3000 lekë.
 - Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve në shumën 3000 lekë.
2. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2023-2024, do të jetë sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimeve, i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
4. Studentët në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor paguajnë tarifë shkollimi për tre vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor). Studentët në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë paguajnë tarifë shkollimi për pesë vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor).
5. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit Tiranë.



KRYETARI
PROF.DR.ARTAN HOXHA

Tabela 1

Tarifat e shkollimit në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" dhe në një program të integruar të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2023-2024

Nr.	FAKULTETI/ FILIALI	Lloji i programit të studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore e shkollimit (në lekë)	Tarifa vjetore e shkollimit për program të dytë, (në lekë)
1	Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	Bachelor	Histori	30,000	60,000
		Bachelor	Gjeografi	30,000	60,000
		Bachelor	Gjuhë- Letërsi	30,000	60,000
		Bachelor	Gazetari	30,000	60,000
		Bachelor	Arkeologji	30,000	60,000
2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Bachelor	Biologji	25,000	50,000
		Bachelor	Bioteknologji	25,000	50,000
		Bachelor	Matematikë	25,000	50,000
		Bachelor	Fizikë	25,000	50,000
		Bachelor	Informatikë	25,000	50,000
		Bachelor	Kimi	25,000	50,000
		Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	25,000	50,000
		Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	25,000	50,000
		Bachelor	Inxhinieri Matematike dhe	25,000	50,000
		Bachelor	Teknologji Informacioni	25,000	50,000
3	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Bachelor	Gjuhë Angleze	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Frënge	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Gjermane	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Italiane	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Greke	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Turke	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Ruse	25,000	50,000
		Bachelor	Gjuhë Spanjolle	25,000	50,000
4	Fakulteti i Shkencave Sociale	Bachelor	Psikologji	40,000	80,000
		Bachelor	Punë sociale	40,000	80,000
		Bachelor	Filozofi	40,000	80,000
		Bachelor	Sociologji	40,000	80,000
		Bachelor	Shkenca Politike	40,000	80,000
		Bachelor	Administrim dhe Politika Sociale	40,000	80,000
5	Fakulteti i Ekonomisë	Bachelor	Administrim Biznes	35,000	70,000
		Bachelor	Ekonomiks	35,000	70,000
		Bachelor	Financë	35,000	70,000
		Bachelor	Informatikë Ekonomike	35,000	70,000
6	Fakulteti i Drejtësisë	Bachelor/Program i integruar	Drejtësi	40,000	63,000
7	Filiali i UT-së Sarandë	Bachelor	Administrim Biznes	35,000	70,000
		Bachelor	Gjuhë Angleze	25,000	50,000